

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1/1 dhe nenin 24 paragrafi 1/2 të ligjit për shoqata dhe fondacione (Gazeta zyrtare e RMV nr. 52 e 16 prillit viti 2010); si dhe në bazë të nenit 13 paragrafi 7 të statutit/3 të shoqatës KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË Shkup, në 27.12.2019, në një seancë të jashtëzakonshme të KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË Shkup, e solli dhe miratoi:

## **S T A T U T I N**

### **E shoqatës KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT Shkup**

**-Tekst i rafinuar-**

## **I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **NENI 1**

Shoqata KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT Shkup (në tekstin vijues KOMITETI I HELSINKIT), është një shoqatë e pavarur, jo partiake, jo religjioze, jo fitimprurëse e qytetarëve, e financuar nga projekte, donacione, anëtarësi, burime personale dhe të tjera.

---

1 LIGJI PËR SHOQATAT DHE FONDACIONET Gazeta Zyrtare e RSM, nr. 52, datë 16.04.2010, neni 18 paragrafi 1 „shoqata ka statut“

2 LIGJ PËR SHOQATAT DHE FONDACIONET Gazeta Zyrtare e RSM, nr. 52, datë 16.04.2010, neni 24 paragrafi 1 „Kuvendi punon në seanca“

3 STATUTI I KOMISIONIT TË HELSINKIT - i adoptuar dhe miratuar në seancën e Komitetit e mbajtur më 27 Prill 2018, neni 13 paragrafi 7 shprehet - në kompetencën e Kuvendit është si vijon: - „vendos për ndryshimet statutore të shoqatës;“

### **NENI 2**

Komiteti i Helsinkit ka statusin e personit juridik.

Selia e shoqatës është në Shkup, në rr. “Naum Naumovski Borçe” nr. 83/1

### **NENI 3**

Komiteti i Helsinkit punën e tij e bazon në parimet e publicitetit dhe transparencës dhe promovon lirshëm pikëpamjet dhe opinionet e tij, inicion dhe merr pjesë në ndërtimin e opinionit publik dhe krijimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

### **NENI 4**

Qëllimi i Komitetit të Helsinkit është të punojë për respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përfshira në Aktin Final të Helsinkit të vitit 1975 dhe traktateve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Objektivat e veçantë të Komitetit të Helsinkit janë:

- avancimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.
- ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat dhe liritë e tyre dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre.
- krijimin e një mjedisi që mundëson realizimin e të drejtave të qytetarëve në shoqëri si tërësi

### **NENI 5**

Për të arritur qëllimet dhe objektivat e tij Komiteti i Helsinkit vepron në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes:

- Monitorim sistematik të situatës së të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj.
- Sigurim të ndihmës juridike paraprake, ndihmë juridike dhe ndihmë juridike falas për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Përgatitja e raporteve për situatën e të drejtave të njeriut dhe publikimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
- Përgatitja, përkthimi, botimi dhe shpallja i botimeve që lidhen me teorinë dhe praktikën e të drejtave të njeriut.

- Organizim të konferencave, seminareve, veprimeve publike dhe formave të tjera të veprimtarisë qytetare në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

- Zhvillimi i demokracisë, shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut.

## **II ANËTARË TË SHOQATËS**

### **NENI 6**

Anëtarë të Komitetit të Helsinkit mund të jenë qytetarë të rritur, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, raca, statusi shoqëror, orientimi seksual, identiteti dhe shprehja gjinore, paaftësia fizike dhe intelektuale ose ndonjë karakteristikë tjetër personale, që janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose të huaj me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Anëtarët e Komitetit të Helsinkit janë qytetarë/e aktiv që vullnetarisht do të paraqesin kërkesë për anëtarësim në Komitetin e Helsinkit.

Me nënshkrimin e formularit të aplikimit, anëtarët pranojnë Statutin e Komitetit të Helsinkit dhe shprehin gatishmërinë e tyre të jenë anëtarë si individë dhe të ofrojnë ekspertizën e tyre në fusha të caktuara në zbatimin e aktiviteteve dhe të punës.

### **NENI 7**

Për pranimin e një anëtari të ri vendos Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues shqyrton kërkesën për anëtarësim dhe përcakton që kandidati/kandidatja plotëson kushtet për anëtarësim dhe pranon këtë Statut dhe Programin e Komitetit të Helsinkit.

Anëtarët paguajnë anëtarësimin vjetor, shumën e së cilës e përcakton Kuvendi, dhe mospagimi i anëtarësimit për vitin të mëparshëm do të thotë përjashtim nga anëtarësia.

Komiteti i Helsinkit mban regjistër anëtarësie për anëtarët e tij, i cili azhurohet një herë në vit.

## **NENI 8**

Anëtarët e Komitetit të Helsinkit kanë të drejta dhe përgjegjësi në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe rregulloret pozitive ligjore. Anëtarët kanë këto të drejta dhe detyrime.

- Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Komitetit të Helsinkit;
- Të propozojë zgjidhje për çështje me interes të përbashkët;
- Të punojë për zhvillimin dhe promovimin e veprimtarive shoqërore dhe të tjera që dalin nga Statuti, qëllimet dhe objektivat programore dhe vendimet dhe konkluzionet e miratuara;
- Të zbatojë plotësisht dispozitat e Statutit dhe aktivitetet programore;
- Të përfaqësojë interesat dhe qëndrimet e organizatës;
- Të kërkojnë ndihmë profesionale dhe tjetër në fushën e punës së Komitetit të Helsinkit;

## **NENI 9**

Secili anëtar vullnetarisht mund të japë dorëheqje nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, për të cilin ai / ajo duhet të paraqesë një njoftim me shkrim.

## **NENI 10**

Anëtari mund të shkyçet për vepra në kundërshtim me vlerat dhe parimet e Komitetit të Helsinkit, duke shkaktuar dëme në veprimtarinë dhe reputacionin e organizatës dhe duke vepruar në kundërshtim me Statutin dhe aktet e Komitetit të Helsinkit.

Procedurë për shkyçjes mund të ngrejë;

- Pesë anëtarë të Kuvendit;
- Dy anëtarë të Këshillit Drejtues;
- Kryetari i Komitetit të Helsinkit;

Vendimi për shkyçje merret nga Këshillit Drejtues me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Vendimi për shkyçjen e një anëtari konfirmohet nga Këshilli Mbikëqyrës me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Në rast konflikti midis vendimeve të Këshillit Drejtues dhe Mbikëqyrës, vendos Kuvendi.

### **III OGANET E KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **NENI 11**

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut drejtohet nga anëtarësia direkt ose përmes përfaqësuesve të saja.

Organet e Komitetit të Helsinkit janë:

1. Kuvendi;
2. Këshilli Drejtues;
3. Kryetari;
4. Këshilli Mbikëqyrës;
5. Drejtori Ekzekutiv;

Për të përmbushur detyrat dhe qëllimet e shoqatës, Komiteti i Helsinkit ka një zyrë ekzekutive me të cilën drejton Drejtori Ekzekutiv.

#### **NENI 12**

#### **KUVENDI**

Kuvendi është organi më i lartë i Komitetit të Helsinkit dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e tij.

#### **NENI 13**

Në kompetenca të Kuvendit është që:

- Të miraton Statutin, programin dhe akte të tjera;
- Të miraton një raport vjetor të punës dhe një raport financiar të botuar në web faqen e internetit të Komitetit të Helsinkit;
- Të dorëzon një raport financiar pranë organit kompetent të administratës shtetërore, pra organit të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit në rastet kur përdor fonde nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale;
- Vendos për ndryshimin e qëllimit të shoqatës;
- Vendos për organizimin e brendshëm dhe format e organizimit të organeve të shoqatës;
- Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshillin Mbikëqyrës me shumicë votash nga numri i pranishëm i anëtarëve;
- Vendos për ndryshimet statutare të shoqatës;
- Vendos për përfundimin e shoqatës me një shumicë prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të shoqatës dhe;
- Kryen veprimtari të tjera në përputhje me Statutin dhe aktet e shoqatës;

## **NENI 14**

Kuvendi punon në seanca dhe mbledhet sipas nevojës, dhe sipas rregullit një herë në vit mban një seancë të rregullt.

Kuvendi vendos me plotë fuqi nëse më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve janë të pranishëm.

Sipas rregullit, Kuvendi miraton vendimet me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

## **NENI 15**

Seanca e Kuvendit thirret nga:

- Kryetari i Komitetit të Helsinkit,
- Me propozimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit Drejtues të Komitetit të Helsinkit;
- Me propozimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit;

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për administrimin e seancave të Kuvendit

Vendimet e Kuvendit janë të detyrueshme për të gjithë organet dhe anëtarët e Komitetit të Helsinkit

## **NENI 16**

Kuvendi thirret me ftesë për të gjithë anëtarët e Komitetit të Helsinkit, me datë, vendin e mbajtjes dhe rendin e ditës të seancës.

Kuvendi zgjedh një kryesues për secilën seancë veç e veç.

Për Kuvendin mbahet procesverbal, të cilin e konfirmon kryesuesi i Kuvendit dhe Këshillit Drejtues.

## **NENI 17**

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit mbahet jo më vonë se 30 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për mbajtje, dhe thirret në të njëjtën mënyrë si Kuvendi i rregullt.

Në rastet kur prania e më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve për mbajtjen e një kuvendi të jashtëzakonshme nuk mund të sigurohet, anëtarët mund të votojnë në formë elektronike, vetëm për veprimet në lidhje me organizimin e brendshëm të KHM.

## **NENI 18**

### **Këshilli Drejtues**

Këshilli Drejtues i Komitetit të Helsinkit është organi drejtues i shoqatës, në të cilin secili anëtar ka të drejta të barabarta. detyrime dhe përgjegjësi për funksionimin dhe zhvillimin e Komitetit të Helsinkit në përputhje me Statutin.

Këshilli Drejtues përbëhet nga të paktën pesë, por jo më shumë se nëntë anëtarë.

Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen nga Kuvendi, nga shumica e numrit të anëtarëve të pranishëm në Kuvend.

Për punën e tyre, anëtarët e Këshillit Drejtues llogari i japin Kuvendit.

## **NENI 19**

Kandidat për anëtar të Këshillit Drejtues mund të propozojnë të paktën tre anëtarë të Kuvendit.

Nëse numri i kërkuar i anëtarëve të Këshillit Drejtues nuk është zgjedhur, procedura për zgjedhjen e vendeve të pa plotësuara në Këshillin Drejtues përsëritet brenda një periudhe jo më të gjatë se dy muaj.

Ndryshimin për numrin e anëtarëve të Këshillit Drejtues e përcakton nga Kuvendi.

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë anëtarë të Komitetit të Helsinkit.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues është katër vjet, me mundësi të rizgjedhjes.

## **NENI 20**

Këshilli Drejtues i kryen punët si vijon:

- përgatit dhe përcakton detyrat statutorë dhe programore të Komitetit të Helsinkit, si dhe vendimet dhe konkluzionet e Kuvendit;

- miraton dhe zbaton program vjetor;

- propozon ndryshime dhe plotësime të Statutit;

- përgatit dhe miraton rregullore, udhëzime, programe dhe akte të tjera të brendshme të nevojshme për funksionimin e rregullt dhe të duhur të Komitetit të Helsinkit;

- përcakton menaxherët e projekteve, merr vendim për aplikim, miraton marrëveshjen me donatorin dhe miraton raportet për rrjedhën dhe realizimin e projekteve;

- zgjedh dhe shkarkon Kryetar të Komitetit të Helsinkit nga radhët e tij;

- zgjedh dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv;

- thërret seanca të Kuvendit dhe përgatit materiale për seanca;

- menaxhon dhe është përgjegjës për menaxhimin e pasurisë së Komitetit të Helsinkit;

- merr vendime për formimin e komisioneve të përhershme dhe të kohë pas kohshme, projekteve dhe rrjeteve të bashkëpunëtorëve;

- merr vendime për çmime dhe mirënjohje me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv;

- përgatit raport vjetor ose periodik për punën e vete dhe të Komitetit të Helsinkit;

- kryen edhe punë të tjera që rrjedhin nga Statuti i Komitetit të Helsinkit.



## **NENI 21**

Këshilli Drejtues punon dhe vendos në seanca, të cilat mbahen rregullisht një herë në muaj.

Seancat e rregullta të Këshillit Drejtues thirren dhe kryesohen nga Kryetari i Komitetit të Helsinkit ose në mungesë të tij nga cili do prej anëtarëve.

Propozim për thirrjen për seancë mundet të paraqes vetëm edhe një anëtar i Këshillit Drejtues. Në atë rast, Drejtori Ekzekutiv është i detyruar të caktojë seancë edhe pa praninë e Kryetarit të Komitetit të Helsinkit.

Propozim për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme mund të paraqitet nga të paktën pesë anëtarë të Kuvendit dhe Drejtori Ekzekutiv.

Kryetari i Komitetit të Helsinkit është i detyruar të thërrasë seancë brenda pesë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Thirrjet bëhen me ftesë, me kohë, vendin dhe propozim rrendin e ditës të seancës.

Këshilli Drejtues mund të punojë dhe të vendosë nëse të paktën dy të tretat e numrit të anëtarëve janë të pranishëm në seancë.

Koordinator/e projekti dhe punonjës të Komitetit të Helsinkit mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, pa të drejtë vote, dhe si rregull sa herë që diskutohet për projektin ku janë angazhuar.

Këshilli Drejtues vendimet e veta i sjell me shumicë absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Për punën e seancave mbahet procesverbal i punës i cili miratohet në seancën e ardhëshme.

## **NENI 22**

### **Kryetari i Shoqatës**

Kryetari është përfaqësuesi ligjor i shoqatës.

Kryetari përfaqëson dhe prezanton Komitetin e Helsinkit në marrëdhëniet me palët e treta, organet dhe organizatat në vend dhe jashtë tij.

Kryetari mund të autorizojë Drejtorin Ekzekutiv ose një anëtar tjetër të Këshillit Drejtues që të përfaqësojë dhe prezantojë Komitetin e Helsinkit në marrëdhëniet me palët e treta, organet dhe organizatat në vend dhe jashtë tij.

Kryetari është anëtar me të drejta të plota i Kuvendit dhe Këshillit Drejtues, dhe është përgjegjës për zbatimin e Statutit, vendimeve, qëndrimeve dhe politikave të Kuvendit dhe Këshillit Drejtues.

Kryetari për punën e tij i përgjigjet Kuvendit.

Kryetari është përgjegjës për zhvillimin e veprimtarive të Komitetit të Helsinkit dhe Këshillit midis dy seancave të Këshillit Drejtues.

Kryetari në mënyrë elektronike informon dhe konsulton Këshillin Drejtues për të gjitha aktivitetet dhe vendimet e rëndësishme.

## **NENI 23**

Propozim për zgjedhjen e Kryetarit mund të propozohet nga të paktën dy anëtarë të Këshillit Drejtues.

Kryetari, si rregull, zgjidhet në seancën konstituive të Këshillit Drejtues ose në seancë pas dorëheqjes, shkarkimit ose pamundësisë për të kryer funksionin e kryetarit. Në seancë duhet të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

Kryetari zgjidhet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Mandati i kryetarit është katër vjet me të drejtën e një rizgjedhjeje.

Kryetari mund të shkarkohet në të njëjtën mënyrë si është zgjedhur.

## **NENI 24**

### **Këshilli Mbikëqyrës**

Këshilli Mbikëqyrës monitoron zbatimin e Statutit dhe programit, kujdeset për funksionimin dhe pronën e organizatës dhe kryen punë të tjera në mënyrë të përcaktuar me këtë Statut.

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga tre anëtarë të shquar të Komitetit të Helsinkit, me një mandat prej katër vjetësh me të drejtë në një rizgjedhjeje.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organeve të tjera brenda të cilave mbikëqyrin, as punonjës të organizatës.

Kontrollon zbatimin e veprimtarive financiare të Komitetit të Helsinkit dhe kontrollon disponimin e qëllimshëm të mjeteve dhe të ardhurave të shoqatës.

Këshilli Mbikëqyrës ia dërgon gjetjet dhe vendimet e tij Kuvendit dhe Këshillit Drejtues.

Këshilli Mbikëqyrës shikon realizimin aktual financiar të secilit prej projekteve të Komitetit të Helsinkit në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar për realizimin e projektit.

Këshilli Mbikëqyrës gjithashtu shikon avansimet eventuale dhe vërejtjet e mundshme në lidhje me mënyrën e realizimit të pjesës financiare të projektit, i cilët vinë nga pjesëmarrësit në projekt ose nga donatori dhe për atë informon Këshillin Drejtues dhe nëse është e nevojshme propozon se si të zgjidhet problemi.

## **NENI 25**

### **Drejtori Ekzekutiv**

Për punën e tij administrative dhe afariste, Komiteti i Helsinkit ka Drejtor Ekzekutiv i cili drejton Zyrën Ekzekutive.

Këshilli Drejtues zgjedh Drejtorin Ekzekutiv me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, me propozimin e Kryetarit të Komitetit të Helsinkit.

Drejtori Ekzekutiv zgjidhet për një kohë prej pesë vjetësh, me të drejtë të rizgjidhet.

Drejtori Ekzekutiv drejton dhe është përgjegjës për punën e Zyrës Ekzekutive (punonjësit) dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me Rregulloren për përcaktimin e kompetencave, të drejtave dhe detyrimeve të Drejtorit Ekzekutiv, në përputhje me Statutin e Komitetit të Helsinkit.

Puna, veprimet dhe aktivitetet e tjera që lidhen me Zyrën Ekzekutive rregullohen me Rregulloren e Procedurës për organizimin e punëve dhe detyrave të punës dhe shtesat e Zyrës Ekzekutive të Komitetit të Helsinkit.

## **NENI 26**

Anëtarët e Kuvendit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës (anëtarët e organeve) në çdo kohë, mund të marrin pjesë në punën e organeve, të iniciojnë përgatitjen e akteve të

përgjithshme dhe të marrin pjesë në kryerjen e kompetencave të tjera të Kuvendit, Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës.

## **NENI 27**

Komiteti i Helsinkit mund të krijojë filiale, rrjete dhe grupe joformale.

## **IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **NENI 28**

Komiteti i Helsinkit do të pushojë së punuari nëse:

- është sjellë vendimi për përfundimin e ekzistencës në përputhje me Statutin;
- ka kaluar dy herë më shumë se koha e parashikuar për mbajtjen e seancës së organit më të lartë të përcaktuar me Statut, dhe nuk është mbajtur;
- në dy vjet rresht, nuk është dorëzuar asnjë llogari përfundimtare në përputhje me ligjin;
- është marrë vendim nga një gjykatë kompetente;

Vendimi për pushimin e shoqatës merret nga Kuvendi me shumicën e dy të tretave të anëtarëve.

### **NENI 29**

E drejta për interpretim autentik të këtij Statuti ushtrohet nga Kuvendi, dhe midis dy seancave Këshillit Drejtues i Komitetit të Helsinkit.

### **NENI 30**

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen në të njëjtën procedurë sikur edhe për miratimin e tij.

Propozimin e shqyrton Këshilli Drejtues dhe, së bashku me mendimin e tij, ai u a dërgon të gjithë anëtarëve të Kuvendit, pesëmbëdhjetë ditë para seancës së Kuvendit.

Kuvendi miraton Statutin me shumicë nga anëtarët të pranishëm.

## **NENI 31**

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij, dhe kështu Statuti i Komitetit të Helsinkit nga 27 Prilli 2018 pushon të jetë i vlefshëm.

**KRYETAR I SHOQATËS**